STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 13 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) KRIJON KOMISIONIN MORELAND PER TE HETUAR DHE STUDJUAR PERGATITJEN DHE ADMINISTRIMIN NGA NDERMARRJET E SHERBIMEVE TE STUHISE; DO TE REKOMANDOJE REFORMA PER TE RISTRUKTURUAR RREGULLIMIN E TE GITHE SISTEMIT PER TE TRAJTUAR ME MIRE EMERGJENCAT

Komisioni do të hetojë përgatitjen e ndërmarrjeve dhe do të bëjë rekomandime për të përmirësuar reagimin në të ardhmen ndaj incidenteve të mëdha të motit

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) nënshkroi sot një Urdhër Ekzekutiv për të krijuar një komision sipas Ligjit Moreland që do të hetojë reagimin, përgatitjen dhe administrimin e ndërmarrjeve të shërbimeve të energjisë së Nju Jorkut ndërsa stuhi të mëdha kanë goditur shtetin gjatë dy viteve të kaluara, përfshirë Uraganët Sendi (Sandy) e Irenë (Irene) dhe Stuhinë Tropikale Li (Lee).

Komisioni do të ngarkohet që të ndërmarë një analizë të plotë të të gjitha veprimeve të mara nga ndërmarrjet e energjisë përpara dhe pas këtyre emergjencave dhe të bëjë rekomandime të caktuara për të reformuar dhe modernizuar mbikqyrjen, rregullimin dhe administrimin e shërbimeve të dhënies së energjisë të Nju Jorkut.

“Nga Uragani Irenë (Irene), Stuhia Tropikale Li (Lee) tek Uragani Sendi (Sandy), gjatë dy viteve të kaluara Nju Jorku ka përjetuar disa nga katastrofat natyrore më të këqija në historinë e shtetit tonë,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Ndërsa i përshtatemi realitetit të incidenteve më të shpeshtë të mëdha të motit, duhet të studjojmë dhe të mësojmë nga këto përvoja të kaluara dhe të përgatitemi për të ardhmen.”

Mandati i Komisionit përfshin shqyrtimin dhe bërjen e rekomandimeve për të reformuar përgjegjësitë e misionet e mbivendosura të NYPA, LIPA, NYSERDA dhe të Komisionit të Shërbimit Publik. Siç tregohet nga Uragani Sendi (Sandy), labirinti ekzistues i organeve rregullatore, agjencive e autoriteteve shtetërore dhe organeve pothuajse-qeveritare ka kontribuar në një sistem mosfunksionues të ndërmarrjeve të shërbimeve.

Komisioni do të ketë pushtetin që të thërrasë dhe të pyesë dëshmitarë nën betim. Anëtarët e Komisionit përfshijnë:

Bashkë-Kryetar Robert Abrams, ish-Prokuror i Përgjithshëm i Shtetit të Nju Jorkut
Bashkë-Kryetar Benxhëmin M. Loski (Benjamin M. Lawsky), Kryeinspektor i Departamentit të Shërbimeve Financiare
Pitër Bredford (Peter Bradford), ish-Kryetar i Komisionit të Shërbimit Publik
Toni Kollins (Tony Collins), President i Universitetit Klarkson (Clarkson University)
Xhon Dajson (John Dyson), ish-Kryetar i Autoritetit të Energjisë së Nju Jorkut
Reverendi Floid Flejk (Rev. Floyd Flake), Pastor i Lartë për Katedralen Afrikane Metodiste Episkopale Greater Allen (Greater Allen African Methodist Episcopal Cathedral)
Mark Grin (Mark Green), ish-Avokat Publik i Qytetit të Nju Jorkut
Xhoani Mahoni (Joanie Mahoney), Ekzekutive e Qarkut Onondaga (Onondaga)
Kethlin Rais (Kathleen Rice), Prokurore e Rrethit të Qarkut Naso (Nassau)
Den Tishman (Dan Tishman), Zëvendës/Kryetar i Korporatës së Teknologjisë AECOM dhe Kryetar e CEO i Korporatës së Ndërtimit Tishman

Urdhëri Ekzekutiv që krijon Komisionin është më poshtë:

U R D H E R E K Z E K U T I V

EMERTUAR SIPAS PJESES 6 TE LIGJIT EKZEKUTIV

NDERSA, duke filluar më 29 tetor 2012, Uragani Sendi (Sandy) shkaktoi ndërprerje masive të energjisë anembanë Long Ajlënd (Long Island), Qytetit të Nju Jorkut (New York City), Uestçester (Westchester), Roklend (Rockland) dhe qarqet përreth, duke prekur mbi dy milionë konsumatorë, përfshirë nëntëdhjetë përqind të konsumatorëve në Long Ajlënd (Long Island); dhe

NDERSA, emergjencat e stuhisë kanë prekur, si dhe mijëra të bizneseve dhe siguruesve të shërbimeve private dhe publike të ngarkuar me mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë së banorëve të Nju Jorkut, përfshirë spitale, shtëpitë e të moshuarve, azilet e pleqve dhe banesat e tjera që u shërbejnë personave me pa-aftësi dhe nevoja të tjera të posatçme; dhe

NDERSA, emergjencat e stuhisë sakatosën sistemet kryesore të transportit publik, përfshirë transportin në masë, ura, tunele, rrugë dhe disa rrugë ujore, anembanë rajonit; dhe

NDERSA, humbja e energjisë ndikoi negativisht në një shumëllojshmëri të sistemeve të tjera vendimtare, përfshirë shërbimet e komunikacioneve, terminalet dhe stacionet e benzinës, dërgimin e gazit natyror në banesa dhe dërgimin e avullit në komplekset e mëdha të banimit dhe ato tregtare; dhe

NDERSA, më 7 nëntor 2012, një Noristër (Nor'easter) me dëborë përkeqësoi vuajtjet, dëmin e pronave dhe ndërprerjet e energjisë të përjetuara në disa nga të njëjtat zona të prekura nga Uragani Sendi (Sandy); dhe

NDERSA, ndërprerje të tilla të përjetuara të furnizimit me energji dhe dëmi si rrjedhojë në sisteme të tjera vendimtare në shumë komunitete, lagje dhe zona industrial, si dhe mbizotërimi i vazhdueshëm i linjave mosfunksionuese të ndërmarrjeve të shërbimeve, ka rrezikuar shëndetin dhe sigurinë e banorëve të Nju Jorkut dhe ka dëmtuar besimin publik në sistemin e shërbimeve publike; dhe

NDERSA, në gusht dhe shtator të 2011-tës, si rezultat i Uraganit Irenë (Irene) dhe Stuhisë Tropikale Li (Lee) mbi një milionë konsumatorë në Shtetin e Nju Jorkut mbetën pa energji dhe disa komunitete pësuan mungesa të zgjatura të energjisë që jo vetëm prekën Long Ajlënd (Long Island), Qytetin e Nju Jorkut (New York City), Uestçester (Westchester), Roklend (Rockland) dhe qarqet përreth, por gjithashtu qarqet në Albani (Albany), Brum (Broome), Kenago (Chenango), Kemungu (Chemung), Klinton (Clinton), Kolumbia (Columbia), Delëuer (Delaware), Daçes (Dutchess), Eseks (Essex), Franklin (Franklin), Fulltën (Fulton), Grin (Greene), Hemilltën (Hamilton), Herkimer (Herkimer), Montgomëri (Montgomery), Oneida (Oneida), Otsego (Otsego), Renselaer (Rensselaer), Saratoga (Saratoga), Shenekedi (Schenectady), Shohari (Schoharie), Tioga (Tioga), Tompkins (Tompkins), Uoren (Warren) dhe Uashington (Washington); dhe

NDERSA, në dhjetor 2008, një stuhi akulli shkaktoi mbi 300,000 ndërprerje të energjisë në Shtetin e Nju Jorkut dhe shumë konsumatorë ishin ende pa energji një javë pas stuhisë; dhe

NDERSA, këto ngjarje të fundit dhe të kaluara tregojnë se planifikimi dhe procedurat e reagimit ndaj emergjencës të ndërmarrjeve të shërbimeve duhet të parashikojnë emergjencat e ardhshme dhe të jenë të përgatitura.

NDERSA, ndërmarrjet e shërbimeve kërkohet të sigurojnë shërbime të sigurta, të përshtatshme dhe të besueshme për publikun; dhe

NDERSA, Komisioni i Shërbimit Publik i Shtetit të Nju Jorkut është agjencia rregullatore e ngarkuar me mbikqyrjen e ndërmarrjeve private të shërbimeve në Shtetin e Nju Jorkut, ekziston një labirint i organeve të tjera rregullatore, agjencive shtetërore, autoriteteve e organeve pothuajse-qeveritare, përfshirë, por jo të kufizuar në Autoritetin e Energjisë të Nju Jorkut, Autoritetin e Energjisë të Long Ajlënd dhe Autoritetin e Energjisë dhe Zhvillimit të Kërkimit të Shtetit të Nju Jorkut, mandatet, juridiksionet dhe përgjegjësitë e mbivendosura të të cilëve kanë kontribuar në një sistem mosfunksionues të ndërmarrjeve të shërbimeve; dhe

NDERSA, pyetje të rëndësishme janë ngritur në lidhje me përshtatshmërinë e ndërmarrjeve të shërbimeve, strukturat, burimet, kuadrin rregullator dhe mbikqyrjen e tanishme për të siguruar përgatitjen për dhe reagimin e efektshëm ndaj katastrofave natyrore nga ndërmarrjet e shërbimeve në këtë Shtet, veçanërisht duke ditur shpeshtësinë dhe intensitetin në rritje të katastrofave të tilla, si dhe liçensimin, çertifikimin, mbikqyrjen dhe rregullimin e industrisë së energjisë në Nju Jork sipas ligjit ekzistues; dhe

NDERSA, për të ruajtur besimin publik në sigurimin e shërbimeve jetësore nga ndërmarrjet e shërbimeve, është dukshëm në interesin publik që të studjohet, shqyrtohet, hetohet dhe analizohet secili dhe çdo element përbërës i sigurimit me energji të Shtetit të Nju Jorkut; dhe

NDERSA, Neni IV, Pjesa 3, e Kushtetutës së Nju Jorkut i jep Guvernatorit detyrimin që të kujdeset që ligjet të zbatohen besnikërisht;

TANI, PRANDAJ, UNE, ENDRJU M. KUOMO (ANDREW M. CUOMO), Guvernator i Shtetit të Nju Jorkut, nëpërmjet autoritetit që më është dhënë nga Kushtetuta dhe ligjet e Shtetit të Nju Jorkut, urdhëroj këtu sa më poshtë:

1. Sipas Pjesës 6 të Ligjit Ekzekutiv, këtu emëroj një Komision që: (A) të studjojë, të shqyrtojë, të hetojë dhe të analizojë: (i) përgatitjen dhe reagimin ndaj emergjencave të ndërmarrjeve të shërbimeve gjatë dhe pas ngjarjeve të emergjencës së motit, përfshirë kryerjen e shërbimeve gjatë dhe pas ngjarjeve të emergjencës së motit; (ii) përshtatshmërinë e ligjeve, rregullave, rregulloreve, praktikave dhe procedurave të tanishme në lidhje me përgatitjen dhe reagimin e ndërmarrjeve të shërbimeve; (iii) përshtatshmërinë e mbikqyrjes ekzistuese dhe mekanizmave të detyrimit; (iv) strukturën, organizimin, pronësinë, financimin, kontrollin, administrimin dhe praktikat e ndërmarrjeve të shërbimeve ndërsa ndikojnë në përgatitjen dhe reagimin ndaj emergjencave; dhe (v) sigurimin e shërbimeve për Shtetin e Nju Jorkut sipas kuadrit rregullator ligjor ekzistues, duke përfshirë, por jo të kufizuar në juridiksionin, përgjegjësitë dhe misionet e Autoritetit të Energjisë të Nju Jorkut, Autoritetit të Energjisë të Long Ajlënd, Autoritetit të Energjisë dhe Zhvillimit të Kërkimit të Shtetit të Nju Jorkut, si dhe Komisionit të Shërbimit Publik; (B) të raportojë dhe të bëjë rekomandime për ndryshime legjislative, politike dhe rregullatore, si dhe reforma siç konsiderohen të përshtatshme në strukturën, administrimin dhe praktikat e ndërmarrjeve të shërbimeve, për të mbrojtur dhe për t'i shërbyer më mirë interesit të publikut në lidhje me përgatitjen dhe reagimin ndaj emergjencave dhe sigurimin e shërbimeve të sigurta, të besueshme dhe reaguese; dhe (C) të analizojë çdo cështje ose veprimtari të tjera që mund të ndikojnë në çështjet e përcaktuara këtu më sipër;

2. Komisionit këtu i jepet pushteti për të thirrur dhe për të detyruar pjesëmarrjen e dëshmitarëve; për të administruar betimet ose pohimet dhe për të ekzaminuar dëshmitarët nën betim; për të kërkuar paraqitjen e çdo libri, rregjistri ose dokumentave që konsiderohen se janë të rëndësishme ose kanë lidhje më ndonjë hetim, shqyrtim ose analizë; dhe të kryejë çdo funksione të tjera që janë të nevojshme ose të përshtatshme për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e funksionit dhe këtu i jap e i akordoj Komisionit të gjitha pushtetet dhe autoritetet që mund t'u jepen ose akordohen personave të emëruar prej meje për një qëllim të tillë sipas autoritetit të Pjesës 6 të Ligjit Ekzekutiv. Komisioni mund të ushtrojë çdo një prej pushteteve të tilla në bashkëpunim me çdo organ ose agjenci qeveritare.

3. Komisioni do të sigurojë një raport dhe rekomandime në përfundimin e punës së tij dhe mund të nxjerrë raporte dhe rekomandime të përkohëshme, paraprake dhe periodike.

4. Brenda Urdhërit Ekzekutiv, “shërbime” u referohet njësive të përfshira në sigurimin e energjisë elektrike, gazit dhe avullit.

5. Çdo departament, agjenci, zyrë, divizion, bord, buro, këshill, autoritet dhe korporatë e përfitimit publik e Shtetit do të bashkëpunojë me Komisionin dhe do të sigurojë informacion dhe ndihmë të tillë që Komisioni e përcakton se është e nevojshme në mënyrë të arsyeshme për të përmbushur detyrat e tij.

D H E N E me dorën time dhe me Vulën (Privy Seal) e Shtetit në Qytetin Albani (Albany) këtë ditë të trembëdhjetë të nëntorit në vitin dy mijë e dymbëdhjetë.

NGA GUVERNATORI

Sekretarja e Guvernatorit

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418